REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 534/26 Dt. 13.11.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1.2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, të datës 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 137022, të datës 02.11.2026, të Hyrmet Mamzi, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 137022, të datës 02.11.2026, të Hyrmet Mamzit, zyrtare publike në Komunën e Prizrenit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të saj, e cili i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjike, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor), lejohen mjetet financiare në shumën prej 900.00 € (nëntëqind euro).

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
- Të lartcekurës,
- Arkivës së Kryetarit.